

Gëzuar
fëmijë!

Etika për fëmijë

Dhuratë e përmuajtme, nga revista "Etika"

Viti 2 - Numri 20 - Gusht 2012

Gëzuar
Bajramin!

Gëzuar
Bajramin!



Kjo e ka emrin
DASHKUN

Atmosfera e Bajramit në një zemër të vogël

HYMEJRA KARAGËZ

Po përjetonin ditët e fundit të Ramazanit në shtëpinë e tyre. Në sytë e Zehrës kishte një pikëllim të çuditshëm. Ajo dukej sikur mërzhitej, por edhe gëzohej. Sytë e Zehrës sikur kishin humbur... Sa mbresëlënës ishin iftaret dhe syfytet me xhemat! Supa, pilafi dhe ëmbëlsirat kishin një shije tjetër. Edhe lutjet ishin shumë të ndryshme në Ramazan.

Zehra e donte shumë Ramazanin. Sepse ai ishte muaji që u jepte më shumë emocione adhurimeve që bëheshin për hir të Allahut. Sigurisht, ishte edhe muaji që të jepte për të kuptuar se çfarë është durimi. Ramazani ishte koha për të kuptuar ata që nuk gjejnë dot edhe një kafshatë bukë për të ngrënë. Pra, koha për t'i nderuar ata njerëz në iftar dhe syfyr. Ishte qetësia e ndarjes

së një kafshate buke. Po ashtu, ishte edhe lajmëtari që njoftonte se mirësitë shtohen duke i ndarë me të tjerët...

Ramazani ishte muaji i “durimit”, muaji i ndarjes bashkë me të tjerët dhe muaji i qetësisë shpirtërore. A ka më shumë se kaq?

Ramazani po mbaronte. Kjo ishte arsyeja që Zehra mërzhitej. Por erdhi një çast që befasisht i qeshën sytë. Ramazani po mbaronte, por po sillte Bajramin. Zehra tha: “Bajrami!” Edhe festa e Bajramit është si Ramazani. Është shumë e bukur!

Festa e Bajramit është një ditë ku mblidhen gjyshërit, gjyshet, xhaxhallarët dhe tezet. Dita e festës kalon shumë bukur. Atmosfera e Bajramit i përfshin të gjithë. Kështu që të gjithëve u



qeshet fytyra. Vizita e të afërmve dhe kujtimi i tyre në këtë ditë, i jepte një lumturi të veçantë Zehrës... Kur po mendonte për këto, befasisht u tremb nga zëri i nënës së saj, që i tha:

- Zehra, ku je bijë?
- Këtu, jam mami.
- Hajde, bijë! Në mbrëmje do të shkojmë te gjyshi yt, ndaj dhe përgatitu!
- Në rregull, mami.

Që nga ky çast, nëna nisi ta ndjekë Zehrën fshehurazi. Dëshironte t'i bënte një surprizë. Zehra emocionohet shumë kur merrte para nga prindërit për Festën e Bajramit. Këtë Bajram, nëna e saj, nuk i tha gjë. Zehra e kishte prerë shpresën për këtë. Ajo me bisht të syrit, herë pas here shikonte vajzën. Zehra ndjehej e lumtur.

Nëna dinte dhe një gjë për bijën e saj. Zehra preferonte ngjyrën e kuqërremtë. Ndaj, dhe nëna e saj i kishte marrë një copë prej kësaj ngjyre dhe donte t'ia bënte fustan, i cili do të ishte shpërblim për butësinë dhe humanizmin e Zehrës përgjatë gjithë Ramazanit. Nëna e saj kishte tre ditë që përpiqej për ta qepur fustanin fshehtas Zehrës. Dhe më në fund fustani përfundoi dhe ishte një model i bukur. Tani nëna ndjehej e lumtur. I shkëlqenin sytë. Në atë çast dëgjoi zërin e së bijës, që i tha:

- Mami, po vjen Bajrami!
- Po bijë! Po vijnë ditët e bashkimit.
- Mami, si çdo herë, edhe për këtë Bajram do të shkojmë te teta Mira.

Zehra shkonte gjithmonë te teta Mira. Ajo nuk kishte askënd dhe jetonte e vetme. Zehra ishte bërë si mbesa e saj. Ato e donin shumë njëra-tjetrën.

- Po bija ime! - u përgjigj nëna pas pak. Kjo është diçka e domosdoshme për Bajram. Baj-

ram do të thotë bashkim dhe përkujtim. Do të thotë, që t'i kënaqësh të moshuarit duke i vizituar... Kështu që, mos u bëj merak bija ime! Teta Mira është duke të pritur me padurim...

Ishte dita e fundit e Ramazanit. Zehra ishte më e lumtur se kurrë. Do shtrihej në shtrat për të fjetur dhe, kur të zgjohej... do të ishte bërë Bajram. Eh, sa e kishte pritur këtë festë Zehra!

Zehra po jetonte lumturinë e saj, kur pas iftarit, e thirri papritur nëna. Ajo po i buzëqeshte. Zehra e njihte mirë këtë buzëqeshje.

- Bija ime, pa mbylli një herë sytë! - i tha nëna.

Zehra i mbylli sytë.

- Mami... jam shumë kureshtare...
- Duro dhe pak!..

Tani para Zehrës ndodhej fustani i kuqërremtë, që nëna e saj ia kishte qepur me shumë dashuri.

Zehra hapi sytë ngadalë-ngadalë. Dhe ç'pa..? Një fustan me ngjyrën që pëlqente ajo. Vrapoi, iu hodh nënës në krahë dhe e përqafoi. Përmes përqaqimit Zehra thoshte:

- Maaamiiii! Maaamiiii! Të faleminderit!

Të nesërmen, që ishte dhe dita e parë e Bajramit, Zehra, që mbante veshur dhuratën e nënës, shkuan së bashku te teta Mira. Kur u hap dera, lumturia e teta Mirës shikohej në sytë e saj. "Festa e Bajramit" pëshpëriti teta Mira dhe prej gëzimit i dolën lot nga sytë.

Me fustanin e kuqërremtë, Zehra shëtiti ditën e festës derë më derë për të fituar kënaqësinë e Allahut. Dera e parë, ishte ajo e teta Mirës. Kish-te edhe shumë shtëpi të tjera, ku do të shkonte. Secilin e uronte: "Për shumë mote, Gëzuar Festën e Bajramit!"

DHE NË ËNDËRR...

Gjumi, rehatshmi,
macen e përkundi,
macja gjuetare,
hop, në ëndrra humbi...

Ëndrrën ia trazon
një mi, e kërcënon,
dhe në ëndërr macja
e zë, e kafshon...

EJA, XIXËLLONJË!

Xixë, xixë,
xixëllonjë,
eja, eja
hyr në lojë!



Eja, eja
mos ki frikë,
lojës sonë
i fal dritë.

Shoku i mirë

Të dashur fëmijë,

Dje, kur po ecja në rrugë, pashë se më ishin lagur këmbët. Me vete thashë: “Çfarë është kjo?! Nga doli ky ujë që nuk shikohet nga larg?...” Vendi ku shkela, ishte i lagur dhe dheu ishte bërë baltë. U mundova të kaloja duke kërkuar për pjesë të thata, ndryshe do të humbisja në baltë. Këpucët më ishin bërë gjithë baltë, madje edhe çorapet dhe fundi.

Ndërkohë që mendjen time e preokuponte balta, e cila kishte rënë në rrobat e mia, m'u kujtua një fjalë e babait tim. Babai më thoshte shpesh: “Bija ime! Ai që ecën në papastërti, papastërtia i ngjitet nëpër këmbë.” Kur isha e vogël, një zë nga brenda më shtynte t'i thosha: “Babi! A ecet në papastërti, ndërkohë që ka vend të pastër?” Shpejt hoqa dorë nga pyetja ime, kisha dëshira ta dëgjoja atë.

Babai im më thoshte gjithashtu: “Nëse shkon në një dyqan që shet parfume me esencë dhe kolonjë, edhe ti kënaqesh nga aromat e mira si misk, madje, edhe rrobat e tua fillojnë të mbajnë erë të mirë.”

Unë nuk kam parë ende një dyqan esencash, por poshtë ballkonit tim është një dyqan lulesh. Kur çelnin lulet në stinën e tyre, unë nuk dëshiroja të ndahesha nga ajo aromë e mirë që vinte në ballkon. Veçanërisht, kur çelin lulet e portokallit, unë e shikoja veten sikur po shëtisja në një bahçe me portokaj. Ajo aromë që shpërndahej ishte aq ndikuese dhe magjepsëse, sa që nuk doja të largohesha nga ai mjedis përrallor. Aromat e mira e tërheqin njeriun dhe e kënaqin. Aromat e këqija dhe baltat të ndotin...

Nganjëherë, babai e zgjeronte më shumë temën dhe thoshte: “Nëse shoqërohesh me shokë të mirë dhe shkon te njerëzit e mirë, do të thotë se ke shkuar te dyqani i esencave dhe aromat e mira kalojnë edhe te ti, por nëse ecën në papastërti, bën shokë të këqij dhe shkon te njerëzit e ligj, atëherë të ngjitet edhe ty ligësia e tyre.

Ata që pinë duhan, ua ngjisin erën edhe atyre që u shkojnë pranë. Apo, nëse bëhesh shok me ata që shkojnë pas kënaqësive, lodrave dhe internetit, ndërkohë që mësimet janë të parat që duhen mësuar dhe ti i le pas dore, atëherë edhe ti ke hyrë në kurthin e tyre. Kështu, në vend që të marrësh përgjegjësitë e duhura, të ngjiten në këmbë punë të papastra.

Të dashur fëmijë! Si thoni? Sa mirë kanë thënë gjyshërit, apo jo? Atij që ecën në papastërti, i ngjitet papastërtia në këmbë.

Ndërsa ai që shkon në dyqanin e esencave, i kënaqet shpirti. Cilin duhet të zgjidhni atëherë? Sigurisht dyqanin e esencave...

Vallë, cilët shokë, e përfaqësojnë dyqanin e esencave? Së pari, ai që nuk gënjen asnjëherë, pastaj ai që mëson mësimet, që fal namaz, që agjëron, që i respekton mësuesit, që dëshiron gjithmonë t'i gëzojë prindërit dhe që e do pastërtinë... Pasi, i lexuat këto rreshta, do të ndjeni aromat e esencave të mira që shpërndahen gjithandej... “Përqafojini” ato, dhe sa të lumtur e krenar do ta ndjeni veten!..



Autobusi

Hikmeti ishte nxënës i suksesshëm. Ai mësonte në një shkollë nëntëvjeçare, e cila, ishte shumë larg shtëpisë së tij. Rrugën nga shkolla në shtëpi e bënte çdo ditë me autobus.

Hikmeti ishte edhe kureshtar. Veçanërisht veturat i ngjallnin kureshtje. Markat dhe modelet e tyre i dinte shumë mirë, madje i pëlqente të diskutonte edhe me shokët për to. I ndodhte shpesh të mërzhitej, për shkak se familja e tij nuk kishte ende një makinë... Por ai nuk ua shprehte asnjëherë prindërve të tij dëshirën që kishte. Se Hikmeti e dinte që babai i tij ishte një nëpunës i thjeshtë dhe me vësh-tirësi siguronte jetesën e familjes.

Hikmeti ende nuk e kuptonte se, pse shoku i tij i shkollës, Ahmedi, që banonte në një lagje me të, po shkonte në shkollë më këmbë.

Ishte një ditë me shi. Hikmeti bashkë me disa shokë të tij po prisnin auto-busin. Vuri re se Ahmedi kaloi pranë tyre pa e pasur problem shiun dhe vazhdoi rrugën.

Hikmeti i tha:

- Ahmed, autobusi thuajse mbërriti. Eja, prite me ne, se do të lagesh!

Ahmedi e vazhdoi rrugën duke i thënë:

- Do të shkoj në një vend për të kryer një punë, rrofsh!

E njëjta gjë u përsërit disa herë. Hikmeti filloi të bëhej kureshtar, se përse shoku i tij, Ahmedi, nuk hipte në autobus.

Një ditë, këtë ngjarje ia tregoi nënës së tij.

Nëna e njihte mirë familjen e Ahmedit. Babai i tij kishte vdekur para disa vitesh duke lënë pas gjashtë fëmijë. Nëna e tij e shkretë e siguronte jetesën e familjes duke pastruar shtëpitë e të tjerëve. Prandaj ishte e lehtë të kuptohej se Ahmedi nuk hipte në autobus sepse ishte i varfër...

Hikmeti u mërzhit shumë për këtë. Ai u turpërua që mendonte si të kishte një makinë, ndërkohë që kishte me mijëra njerëz që përpiqeshin me mish e me shpirt për të ngopur barkun... Atëherë, Hikmeti falenderoi Allahun për mirësitë që i kishte dhënë.

Sikur ta kishte dëgjuar këtë hadith fisnik të Pejgamberit tonë (a.s.), ndoshta nuk do të mërzhitej për dëshirat e tij:

“Shikoni ata që janë më poshtë se ju, jo ata që janë më lart.” (Buhari, Rikak,



E ka emrin dashuri...

Rejhan Yst Jeshilbag

Ishte një ditë e ftohtë Ramazani. Nga iftari i ndante edhe pak kohë. Të gjithë ishin të uritur dhe të lodhur. Të gjithë kishin një shqetësim të veçantë. Makinat ecnin sikur po bënin garë me njëra-tjetrën, sepse njerëzit po shpejtonin për të arritur në shtëpitë e tyre.

Midis lumit të njerëzve, binte në sy një djalë 12-13 vjeçar. Dukej sikur nuk donte t'ia dinte për asgjë. Kishte rroba të grisura, thonjtë të pistë dhe flokë të pluhrosura.

Djali, nuk merrej me ndokënd dhe as të tjerët nuk merreshin me të. Qëndronte i vetëm midis njerëzve që lëviznin. Vëmendjen e kishte fokusuar tek një copë beze që e shtrëngonte fort në dorë. Njësoj si një fëmijë i vogël që mban dorën e nënës së tij dhe s'e lëshon... Dukej sikur ajo copë beze ishte e vetmja lidhje e tij me këtë jetë. I merrte erë, i merrte erë dhe përsëri i merrte erë dhe s'ngopej... Në atë çast para syve iu shfaq nëna. Njëherë e një kohë, kështu i kishte marrë erë edhe ajo, dhe e kishte shtrënguar fort në kraharorin e saj.

Po kush ishte ky fëmijë? Si quhej? Ku e kishte shtëpinë dhe familjen? Çfarë

hante dhe çfarë pinte? Ku flinte, ku zgjohet? Ku...

Ky fëmijë kishte krevatin aty poshtë urës, i cili ishte edhe dhoma e tij. Për çarçafë kishte borën e për jorgan kishte erën. Megjithatë, këto sikur nuk kishin rëndësi për të. Ajo që kërkonte, nuk ishte as krevati, as jorgani, as... Po çfarë ishte ajo që kërkonte vallë? Të gjitha pyetjet radhiteshin njëra pas tjetrës dhe dukej sikur pikëpyetjet zgjateshin për kilometra të tëra mbi asfalt.

Po kush ishte ky fëmijë? Nga kishte ardhur? Ku e kishte shtëpinë dhe familjen? Si quhej? E kishte emrin Ahmed apo Ali?... Përse ishte në këtë gjendje dhe përse kishte zgjedhur këtë lloj jete? Kushedi, mbase... nuk e kishte zgjedhur vetë. Kush është ai që dëshiron të jetë kaq larg diellit, kur Dielli është shpresë, lumturi dhe paqe? Mirëpo, midis tij dhe njerëzve dukej sikur qëndronte një ajsberg i stërmadh. Një ajsberg i cili nuk mund të shkrihej, edhe nëse do të qëndronte vazhdimisht nën diell...

Rrugës, të gjithë iknin prej tij. Sikur e linin vetëm... Megjithatë edhe ai ishte një njeri. Mbase dikur... edhe ai kujtonte

dhe rikujtonte se një dorë ia përkëdhelte flokët, dy buzë ia puthnin faqet. Kujtonte edhe ai se dikur... kishte qenë shumë i lumtur... Vallë, çfarë kishte ndodhur më pas? Si perëndoi dielli kaq papritur për të..? Dielli nuk i linte njerëzit në mes të rrugës dhe nuk u mbyllte kapakët e syve ndaj kësaj bote... Ai i do shumë njerëzit dhe e ngroh botën. Po për të, përse ishte shuar vallë, ai diell?..

Ezani ishte kënduar. Në çdo shtëpi ishte hapur iftari dhe duatë kishin përfunduar. Në çdo sofër ishte shpërndarë lumturia. Radha i kishte ardhur përgatitjes për namazin e teravive. Çezmat në oborret e xhamive ishin plot me myslimanë që pritnin radhën të merrnin abdest. Dritat e minareve zbukurorin qiellin në errësirën e natës. Dukej sikur minareve elegante me gjysmë hëne në krye, u ishin varur në qafë gjerdane me perla farfuritëse.

Ata që merrnin abdestin e mbanin frymën drejt e në xhami. Në mes të këtij nxitimi, u dëgjua zëri i muezinit.

- Allahu Ekber, Allahu Ekber!

Ishte një thirrje për të falënderuar Krijuesin. Thirrja e fundit e ditës! Po këndohej ezani i Jacisë.

Po djali i vogël ishte ende aty, në mes të rrugës, në botën e tij të vetmuar. Ato që kalonin pranë tij, as që i hidhnin shikimet. Djali ecte ngadalë, i zhytur në mendime. Tani, Namazi i Jacisë dhe i Teravisë kishte mbaruar. Njerëzit i kishin hapur duart dhe kishin kërkuar ato që dëshironin prej Zotit të tyre. Pastaj të gjithë ndaheshin të lumtur dhe me shpirt të qetë prej xhamisë.

Nga çasti në çast, lëvizjet e nje-

rëzve ishin edhe më të pakta. Dyqanet, njëri pas tjetrit po fiknin dritat dhe po ulnin rulletat. Errësira kaploi çdo vend. Djali ishte vetëm, krejtësisht i vetëm. Një fëmijë i vetmuar në mes të rrugës, në një natë Ramazani. Kjo histori nuk duhet të kishte mbaruar kështu... Sepse kjo mbrëmje Ramazani, ashtu si mbrëmjet e tjera, vjen si një përqaftim mëshire për të gjitha rrugicat e vendit. Kjo mbrëmje përqafton edhe të gjithë të vetmuarit, të mjeruarit, të uriturit dhe të eturit për dashuri... Kjo është arsyeja që në mbrëmjet e Ramazanit duhet të vrojtojmë përreth... Duhet të kërkojmë një fytyrë fëmije që ka nevojë për dashurinë tonë, dhe t'ia falim... Duhet të gjejmë sytë e fëmijëve të vetmuar, të takohemi me ta, dhe t'i mbushim me JETË... Ta kërkojmë edhe personazhin tonë 12 vjeçar. Dhe, patjetër që e kemi gjetur... Shpirtin ia kemi mbushur me ngrohtësi...

Nuk ka gjë më të bukur se të ngrohësh zemrën e një fëmijë në një mbrëmje Ramazani. Kjo e ka emrin DASHURI...





Behlul
Bera

Një mësim nga mësimet e Hadithit

- pjesa e gjashtë -

Samiu i vogël në mbrëmje bashkë me familjen e tij bënë 45 minuta mësim hadithi. Ata përpiqeshin t'i komentonin ngjarjet e ditës nën dritën e haditheve, që kishin lexuar. Samiu i vogël përfitonte shumë nga këto mësimet dhe në jetën e përditshme përpiquej të vepronte ashtu siç ka porositur i Dërguari i Allahut (a.s.).



PAKETAT E VEÇUARA,
I RANË NË SY SAMIUT TË VOGËL.




ISHTE DITA E
FUNDIT E MUAJIT
RAMAZAN. AHMETI
KISHTE ARDHUR
ME DISA PAKETA
NË DORË. ISHIN
DHURATAT E FESTËS
SË BAJRAMIT PËR
SAMIUN E VOGËL
DHE FËMIJËT E
TJERË. AHMETI U
DHA TË GJITHËVE
NGA NJË DHURATË,
POR DISA PAKETA I
NDAU MËNJANË.



Ato janë surprizat e Bajramit!
Pas namazit të Bajramit, do ta
shuash kureshtjen tënde.

Babi,
përse i veçove
këto paketa?!

SURPRIZA E BAJRAMIT E BËRI SHUMË KURESHTAR
SAMIUN E VOGËL. ATË E ZURI GJUMI ME VËSHITRËSI
PËR SHKAK SE ISHTE I EMOCIONUAR.



NË MËNGJES
U ZGJUA HERËT DHE FILLOI
TË PËRGATITEJ PËR BAJRAM.



NAMAZIN E BAJRAMIT
E FALI BASHKË ME BABANË,
VËLLAIN E MADH DHE BANORËT
E TJERË TË LAGJES.



Gëzuar
Bajramin,
zotëri!

Gëzuar
Bajramin!

BESIMTARËT IA URUAN NJËRI-TJETRIT FESTËN
E BAJRAMIT, ASHTU SIÇ BËJNË GJITHMONË
PAS NAMAZIT TË BAJRAMEVE.



Për shumë
mot Bajramin,
inshallah!


Gëzuar Bajramin,
nënë e dashur!




Pasi të hamë
mëngjesin, të gjithë
sëbashku do të
shkojmë në një
vend, inshallah.

Edhe kjo duhet të jetë
një pjesë e surprizës.

PAKETAT QË KISHTE VEÇUAR PAK MË PARË
AHMETI, U VENDOSËN ME KUJDES NË
BAGAZHIN E MAKINËS.




TË GJITHË SË BASHKU, SI FAMILJE,
ATA MORËN RRUGËN DHE DOLËN JASHTË
QENDRËS SË QYTETIT.



PAS PAK,
NDALUAN PËRPARA NJË VENDI,
QË ISHTE PLOT ME BARAKA.



Mirë se
erdhe, xhaxha
Ahmet!




Allah, Allah!
Ky fëmijë, nga e
njej babanë tim?



ARIFI KISHTE NJË SËMUNDJE KRONIKE. E SHOQJA,
ZONJA HATIXHE, LODHEJ E DËRMOHEJ DUKE U
SHËRBYER TË SHOQIT DHE DJEMVE TË SAJ, HASANIT
DHE HYSENIT. JETA E TYRE ISHTE E VËSHTIRË.

AHMETI E
VIZITONTE
SHPESH ARIFIN
DHE PËRPIQËJ TA
NDIHMONTË.



SAMIU I VOGËL: "DOMETHËNË,
KJO PASKA QENË SURPRIZA
E BABAIT!" NGA NJËRA ANË
MENDONTE KËSHTU, NDËRSA
NGA ANA TJETËR SHIKONTE
BABANË E TIJ PLOT ADMIRIM.
PASTAJ THA ME VETE: "BABAI
IM ËSHTË, VËRTET, NJË HERO!"

"Edhe unë mund të bëj diçka..."
Në mendje menjëherë i erdhi një mendim.




Hasan, ti je vëllai im besimtar. Nëse pranon, unë dua t'i ndajmë bashkë paratë, të cilat m'i ka dhënë babai për Bajram. Le t'i ndajmë menjëherë...



"ASNJË NUK MUND TË BËHET BESIMTAR I PLOTË PËRDERISA TË MOS DËSHIROJË PËR VËLLANË E TIJ BESIMTAR ATË QË DËSHIRON PËR VETË."

Hadith Fisnik

Familja e Arifit u gëzua shumë në këtë ditë Bajrami. Dhimbjet e tyre u lehtësuan sado pak nga vizita e bukur e xhaxhi Ahmetit. Hasanit i pëlqeu shumë Samiu i vogël. E pa në sy dhe i tha: "Mos harro të vish, kur vjen xhaxha Ahmeti!"



Samiu i vogël shikonte i gëzuar nga xhami. Nga ana tjetër, mendonte: "Sa gjë e bukur është të ndash me të tjerët atë që ke! Vërtet është bukur!"



"Kush ia lehtëson një vështirësi një myslimani në këtë botë, edhe Allahu do ta mbrojë atë prej vështirësive në ditën e kiametit."

Hadith Fisnik

Si e pësoi elefanti...

Një elefant po kalonte nën hije dhe qeshte me të madhe. Ai çdo ditë, çdo mbrëmje që kalonte kësaj ane, nuk bënte gjë tjetër, veçse shkelte barin.

E para që e pa ishte Pema e blirit. Ajo u zemërua shumë nga qeshja tallëse e elefantit. Nuk e duronte dot edhe shkeljen e barit, që bënte elefanti. Prej hidhërimit të madh, vajtonte dhe lëkundej bashkë me erën. Bari ishte shumë i mërzhitur për shkak të fatit të tij të hidhur. Por megjithatë, e ngushëllonte veten duke thënë; "patjetër që në çdo gjë ka një mirësi".

Pema e blirit, për të mos e shfaqur hidhërimin e vet, filloi t'i recitonte vëllait të saj, barit, poezi të mbushura me shpresë. Këto fjalët plot ndjenja të pemës së blirit ishin ngushëllimi i vetëm për barin. Vallë, ku i gjente ato fjalë të bukura? Bari magjepsej sa herë që fliste pema e blirit. Dukej sikur në zemrën e saj fshihej ndonjë bilbil. Gjuha bëhej memec dhe nuk fliste, por zemra nuk heshte. Të gjitha këto ishin fjalët e zemrës. Kur vinte mbrëmja, qëndronin në këmbë duke bërë dua dhe derdhnin lot në sexhde gjer në sabah. Kështu vazhdonin me ditë të tëra...


Çdo mëngjes, Elefanti shkelte trupin delikat të barit. Megjithëse i shkelte trupin, ai nuk mund t'ia lëndonte zemrën. Ditët vazhdonin të kalonin në këtë mënyrë: bënë dua dhe besimi u forcohej dita-ditës.

Kështu, kaloi pranvera, vera, vjeshta dhe erdhi dimri. Bari e mbuloi një bore e bardhë.

Melekët i përkëdhelnin flokët. "Mos u shqetëso", - i thoshin melekët që mbanin flokët e borës në duar. "Zoti yt i dëgjon lutjet e tua të përditshme. Shiko, Ai na dërgoi ne, madje me mijëra prej nesh. Paqja qoftë me ty sot!" Sapo i dëgjoi këto fjalë, bari i falënderoi shumë dhe nga sytë i rrodhën lot gëzimi. Pastaj, ashtu me shpirt të qetë dhe nën përkëdheljet e melekëve, barin e zuri gjumi.

Elefanti, si zakonisht, doli për shëtitjen e tij të përditshme. Sapo u afrua te bari, papritur i rrëshqiti këmba dhe trupi i tij i stërmadh u përplas në tokë. Toka kishte ngrirë dhe ai rrëshqiti e rrëshqiti, pastaj u rrokullis e u rrokullis me shpejtësi dhe ra në humnerë. Thirri disa herë me të madhe e në mënyrë vajtuese, por askush nuk e dëgjoi, askush nuk i dha ndihmë.

Bari, si çdo ditë, u zgjua nga gjumi. Fëshfëri gjelbërueshëm. Nuk dinte se çfarë kishte ndodhur me elefantin. E mori vesh pas pak. Pa pemën e blirit që dukej e gëzuar dhe mbushte vendin me aromën e saj të mrekullueshme. Vetë bari humbi dhe nisi të ëndërrojë në detin e pafund të kësaj arome... Më pas ngriti kokën nga qielli dhe pa mijëra melekë që e përshëndetnin me dorë. Edhe bari i përshëndeste përmes gjelbërimit të tij.



Ambienti i pastër fillon nga shtëpia juaj



Një herë, një sulltan doli të shëtiste rrugëve të qytetit të lindjes. Ngado që hidhte sytë, lemerisej. Rrugët ishin të ndotura nga plehrat. Edhe bahçet, edhe kopshtet ishin të papastruara.

Shëtiti sa shëtiti, më pas, sulltani u kthye i mërzhitur në pallatin e tij. Urgjentisht thirri këshilltarët për të diskutuar rreth kësaj të keqeje që po i kanosej qytetit. Këshilltarët e dëgjuan me vëmendje. Kështu, ministri i mjedisit i kërkoi sulltanit një fond prej 100 mijë napolona ari, duke i premtuar që brenda një muaji rrugët e qytetit do të shkëlqenin nga pastërtia.

- Një muaj, do?! - ia priti sulltani. Është shumë gjatë. Nuk mund ta lëmë në këtë gjendje qytetin edhe një muaj.

Ndërsa ministri i turizmit, për të fituar kënaqësinë dhe simpatinë e vetë sulltanit, i premtoi: “Nëse më vini në dispozicion 400 mijë napolona, rrugët do t’i pastroj për një javë.”

- 400 mijë napolona ari janë shumë për arkën shtetërore, ndaj nuk mundemi..., - ndërhyri guvernatori i thesarit.

Sulltani dëgjonte në heshtje dhe nevrikosej here pas here. Kur mbaroi mbledhja, ai mori rrugën drejt xhamisë. Hoxha i xhamisë, që ishte i moshuar dhe me mjekër të bardhë e pa me vëmendje, iu afrua dhe e pyeti:

- Çfarë të shqetëson, o sulltani ynë?

- Papastëria e rrugëve tona. Na duhen shumë të holla, dhe s’kemi ku t’i marrim. Na duhet kohë, e koha ikën me shpejtësi... Qyteti duhet pastruar shpejt.

Plaku i bardhë e dëgjoji dhe iu përgjigj:

- Madhëri, nuk duhen më shumë se 20 minuta.

- Çfarë, 20 minuta?!.. Mendoni se duhet të boshatisim gjithë thesarin për pastrimin e rrugëve?!..

- Jo, madhëri! Nuk duhet të shpenzosh as edhe një napoleon...

- Si, as edhe një...?! - pyeti sulltani i habitur.

- Shumë e thjeshtë, - ia priti hoxha. Jepni urdhër që secili banor të pastrojë hapësirën para shtëpisë së tij..., dhe do të bindeni për këtë.

Dhe vërtet ashtu ndodhi, siç tha urtësia e hoxhës. Se: “Kush zemrën me besim e pastron, / moralin e tij me virtyte e zbukuron...”

Adelina R. Mamaqi



PËRRALLËZA E SHKRONJËS



ORENDITË

Një mëngjes, orenditë e dhomës filluan të grindeshin:

– Sa e madhe jam! – mburrej bufeja. – Le që, kush nga ju ndrin si unë?

E dëgjoi tryeza dhe u hodh përpjetë me të katër këmbët:

– Cfarë the?! Më e ndritura jam unë! Tek unë shikohesh si në pasqyrë.

Bufeja u mat ta kundërshtonte, por divani ia priti:

– Dale, dale! Pa shikoni sa i madh e i rehatshëm jam unë! Këtu ulen të gjithë njerëzit e shtëpisë!

Pa ia nisën të mburreshin tapeti, frigoriferi, soba, televizori e gjer shtydhësja e frutave, që thoshte se asnjë s'bënte lëngje të freskëta e të shijshme si ajo.

Muret, që po çaheshin nga kjo zhurmë e madhe, u përgjigjën njëzëri:

– Heshtni, se na morët mendtë! Në këtë botë secili ka vlerën e vet.

Dhe vlerat nuk janë kurrë të barabarta.






Çfarë? Përse? Si?

Zehra Aksoj

A JANË TË DËMSHME BATERITË E MBARUARA?

Bateritë që përdorim në aparate të ndryshme gjatë jetës sonë të përditshme si radiot, orët etj., mund të bëhen të rrezikshme edhe për shëndetin e njeriut, edhe për mjedisin përreth. Gjatë përdorimit të tyre, bateritë nuk janë të rrezikshme, por nëse hidhen në plehra pasi të kenë mbaruar, ato bëhen shumë të rrezikshme. Disa bateri, megjithëse në sasi të vogla, përmbajnë disa metale të rënda si kadiumi, plumbi dhe zhiva, të cilat dëmtojnë rëndë shëndetin e njeriut. Pasi hidhen në plehra, mbrojtësja e tyre prej metali konsumohet, copëtohet dhe dalin në pah metalet e rënda. Kur bie shi, uji që rrjedh mbi tokë i merr me vete këto metale dhe i hedh në përrrenj, liqene dhe ujëra nëntokësorë. Si përfundim i kësaj, metalet e rënda, duke u përzierë me ujin dhe zinxhirin ushqimor, mund të hyjnë në trupin e gjallesave. Për këtë arsye, bateritë e mbaruara duhet të mblidhen në një vend të posaçëm derisa të gjendet një mundësi për t'i ricikluar pa dëmtuar gjallesat dhe natyrën.



PËRSE RETË BËHEN NGJYRË GRI PARA SE TË BIE SHI?

Kjo ndodh, sepse retë e shiut janë të dendura dhe të rënda. Retë përbëhen nga kristale të vogla akulli ose nga pika uji. Siç e dimë, ajri i ngrohur ngjitet lart dhe nëse ndesh në ajër të ftohtë dhe përzihet me to, avujt e ujit që ngjiten lart bëhen të dendura dhe formojnë retë. Nëse kushtet janë të favorshme, masat e ajrit të dendur vendosen njëra mbi tjetrën. Nëse pikat e vogla të ujit ose kristalet e akullit që gjenden tek retë bashkohen me molekulat më të vogla që reflektojnë vetëm dritën e kaltër, ato marrin një madhësi e cila i lejon të reflektojnë të gjitha ngjyrat e dritës. Si rezultat, për shkak se i reflektojnë të gjitha ngjyrat, retë duken të bardha.

PËRSE THONË “LOT KROKODILI”?

Kur krokodilët janë duke ngrënë gjahun e tyre, e hapin shumë gojën dhe për këtë arsye, nga sytë e tyre rrjedh një lloj lëngu. Lëngu që u ngjan lotëve, nuk ka të bëjë aspak me hidhërimin e tij. Por duke u nisur nga ky fakt, ka dalë edhe shprehja: “derdh lot krokodili”, megjithëse ai nuk është aspak i hidhëruar. Pra, shprehja ka kuptim figurativ, që në këtë rast flitet për një njeri që kërkon të të mashtrojë, a një njeri që ka disa fytira apo maska.





MENDO PAK... E BUZËQESH

Abdullah Thaçi

Kaltër rreth e qark,
Vala prish qetësinë,
Peshqit ka në bark,
Anijet mbi shpinë?

(dell)

Jetimja prej shtëpisë tretur,
Në mëshirë të njerëz mbetur,
Thonë e bija e mbretit ishte,
Shtatë xhuxhët vëllezër kishte?

(borëbardha)

Një punëtore e përpiktë,
Me gjinkallën ka konflikt
Pse ushqim nuk grumbullon
Po tërë verën - veç këndon?

(bleta)

Tund përpara si një fshesë,
Çdo gjë që i bëhet pengesë,
Si zefir - frikën s'ia kanë,
Kur çmendet bëhet tufan?

(era)

Një vogëlushe e krekosur,
Bardh e verdh e pispillosur,
Me fustan të gëlqerosur?

(eze)

Yti është, ti nuk e sheh,
Përmes tij bota të njeh,
Një gjë dihet gjithsesi,
Ai jeton më gjatë se ti?

(emri)

Postier ishte,
Çantë nuk kishte,
Në sqep i mbante
Letrat që shpërndante?

(pëllumbi)

Aty verës mbysim vapën,
Mbi të dielli derdhi zjarr,
Si kërpudha çadrat hapen,
Nuk ka peshq sa ka notarë?

(plazhi)

NASTRADIN HOXHA





ZBAVITJE



SUDOKU

Nëse i vendosni numrat e mëposhtëm nga e majta në të djathtë dhe nga sipër poshtë do të përftoni shumën 36.



9		8	
	6		12
10		11	8
12		4	

5-12-7-8-15-13-4

	7			6	4	9		8
3				7		9	1	6
	6	1			3			2
1		6	8	4			3	7
7	3				6		8	4
	9			7		6		
		7	6		8			
5	8	3			7		1	6
6			4	3		8		7

Plotësoni çdo rresht, kolonë dhe kutizë, në mënyrë që, çdo shifër nga 1 deri te 9, të shfaqet një dhe vetëm një herë.



Gjeni 7 ndryshimet




Labirinte



Samiu me shokët e tij dëshiron
të shkojë në xhami. A mund t'i ndihmoni
që të gjejnë rrugën?





Qerosi i vogël do të takojë Nastradin
Hoxhën. Ndhmojeni ta gjejë rrugën.



Plotëso foton

Plotësoni vendet bosh të figurës me alternativat që u janë dhënë.





Lagjja Jonë





Erldhi një mik i ri!
Ju fton
miqësinë e tij...



- Tak, tak, tak!
Shkurti troket...



Lexo...



Sa shumë të...
o Profeti ynë...



pyll, në piknik
gjyshin.



Sbkollë,
mirupafshim,
du të vijmë prapë si lule!



Vera i merr me vete,
Fëmijët në male e dete!



TË GJEJME
DASHURI!...



Të jesh mik i mjedisit
është virtyt!
Eja, fitoje edhe ti!...



Kush dhuron, fal dashuri,
s'behet vonë, kurrë, o fëmijë!



Dëbora është
Mirë S...